



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTËR SHTETI PËR  
SIPËRMARRJEN DHE  
KLIMËN E BIZNESIT

**STARTUP  
ALBANIA**

**THIRRJA PËR MBËSHTETJEN E KOMPANIVE  
STARTUP DHE LEHTËSUESIT E START UP-eve  
NËPËRMJET GRANTEVE DHE MASAVE  
MBËSHTËTËSE 2025**

**RREGULLORE E THIRRJES**

#GRANT2025

Versioni 1, Nentor 2024

Programi për mbështetjen e kompanive startup dhe lehtësuesit e start up-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse 2025 është krijuar nga qeveria Shqiptare për të stimuluar sipërmarrjen inovative duke ofruar financim për kompanitë startup më premtuese shqiptare.

Duke njohur vështirësitë në sigurimin e fondeve për ciklin e zhvillimit në fazën e hershme dhe koston e lartë për të përkthyer një produkt ose shërbim në një kompani të sukseshme, është krijuar programi për të ndihmuar në vazhdimësi kompanitë startup dhe lehtësuesit e start up-eve në një faze kritike të zhvillimit dhe për t'u mundësuar sipërmarrësve në Shqipëri të ndërtojnë bizneset e tyre inovative në vend. Kompanitë dhe përfituesit e tjerë që marrin financim nëpërmjet këtij programi pritet të ofrojnë një model të përdorshëm komercialisht, tregtojnë një pilot ose ofrojnë një produkt ose shërbim të gatshëm për tregun dhe shtrirje tek klientët e parë potencialë gjatë kohëzgjatjes së projektit.

Mbështetjen me grant e përfitojnë *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve të vetëdeklaruar në regjistrin elektronik të *startup*-eve dhe lehtësuesve, që janë të pajisur me pasaportën përkatëse. Aplikantët mund të jenë individë, nomadë dixhitalë, kompani private mikro, të vogla dhe të mesme të themeluara në Shqipëri, jo më të vjetra se 6 vjet në momentin e aplikimit.

Financimi i dhënë nga qeveria Shqiptare në kuadër të mbështetjes me grante 2025, do të mbulojë 100% të kostove totale të projektit për aplikantët fitues në fazën e parë – Faza e Ndërtimit të Konceptit; 85% të kostove për aplikantët fitues në fazën e dytë – Faza e Validimit dhe 75% të kostove për aplikantët në fazën e tretë – Faza e Zgjerimit dhe Ndërkombëtarizimit. Afati I implementimit të projekteve për vitin 2025 do të jëtë afërsisht 9 muaj.

Vendimet e financimit do të merren në bazë konkurruese nga një komision i vlerësimit i përbërë nga specialistë të ekosistemit, administrate shtetërore dhe pjestarë të akademisë. Numri i projekteve fituese do të përcaktohet nga cilësia e aplikimeve dhe do të jenë subjekt i totalit të fondeve të disponueshme ose të alokuara për vitin 2025. Gjithashtu, në mbështetje të këtij programi, Agjencia Startup Albania do të ofrojë mbështetje me mentorë dhe trajnime në fusha të tilla si zhvillimi i biznesit, marketing, shitjet, mbrojtjen dhe menaxhimin e pronësisë intelektuale dhe të tjera, në varësi të nevojave specifike të startup-eve. Ky Manual i Thirrjes ofron informacion në lidhje me kriteret dhe procedurat e aplikimit dhe ne shpresojmë se informacioni do t'ju ndihmojë të lundroni lehtësisht gjatë procesit. Manuali i Thirrjes dhe procedurat përkatëse janë ndërtuar për të qenë transparente, të drejta dhe mbi të gjitha, për të evidentuar dhe mbështetur sipërmarrësit më të talentuar dhe kompanitë startup më të mira që operojnë në Shqipëri.

**Delina Ibrahimaj,**  
**Ministër I Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit**



## Table of Contents

<b>PËRKUFIZIMET</b> .....	4
<b>1. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT</b> .....	5
1.1 SHUMA DHE LLOJI I FINANCIMIT .....	5
<b>2. KATEGORITË PËRFITUESE TË GRANTIT</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>3. PRANUESHMËRIA E APLIKANTËVE</b> .....	6
<b>4. PËRDORIMI I FONDEVE TË GRANTIT</b> .....	8
4.1 KOSTOT E PRANUESHME .....	8
4.2 KOSTOT E PAPANUESHME:.....	9
4.3 AKTIVITETE TË PAPANUESHME: .....	10
<b>5. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR STARTUP-ET DHE LEHTËSUESIT E START UP-EVE</b>	10
<b>6. PROCEDURA E APLIKIMIT</b> .....	11
7. NGRITJA E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE ANKIMIT .....	12
<b>8. VLERËSIMI I KËRKESAVE PËR MASA MBËSHTETËSE</b> .....	13
<b>9. PROCEDURA E DISBURSIMIT TË GRANTIT</b> .....	14
<b>10. VLERËSIMI DHE VENDIMI PËR FINANCIM</b> .....	15
<b>11. PËRGJEGJËSITË E FITUESVE</b> .....	18
<b>13. KONFIDENCIALITETI I TË DHËNAVE</b> .....	19

## PËRKUFIZIMET

Aplikant	Kompania/individ i aplikues
Buxheti i miratuar i projektit	Buxheti i projektit i miratuar nga komisioni i vlerësimit pjesë integrale e Marrëveshjes Financiare.
Fituesi	Një aplikant i kualifikuar që ka marrë një njoftim nga Agjencia Startup Albania dhe që ka nënshkruar Marrëveshjen Financiare me Agjencinë Startup Albania.
Aplikimi	Paketa e të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të nevojshme për të mundësuar aplikimin.
Marrëveshja e financimit	Një dokument i nënshkruar nga Fituesi dhe Agjencia Startup Albania, që rregullon kushtet dhe termat sipas programit të financimit.
Projekt	Zhvillimi i projektit dhe aktivitetit aktual të biznesit siç përshkruhet në aplikimin e paraqitur.
Startup Albania	Agjencia Shtetërore për Mbështetjen e Startup-eve dhe Lehtësuesve
PI	Pronësia Intelektuale dhe Industriale

## 1. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Objektivi i programit Grant2025 është të stimulojë sipërmarrjen dhe krijimin inovativ të bazuar në dije, nëpërmjet bizneseve startup të sektorit privat, duke ofruar financim për projekte të orientuara nga tregu me potencial të lartë komercializimi dhe një model biznesi të shkallëzuar. Gjithashtu, programi synon të stimulojë bashkëveprimin e start up-eve me lehtësuesit, si edhe të nxisë bashkëpunimin mes aktorëve të ndryshëm në treg për zhvillimin e ideve inovative. Fondi i alokuar nga Qeveria Shqiptare synon të ofrojë mbështetje financiare për fazat vendimtare të zhvillimit të startup-eve dhe të përmirësimeve thelbësore në produkte, platforma, procese ose shërbime të reja dhe ekzistuese.

### 1.1 SHUMA DHE LLOJI I FINANCIMIT

Shuma totale dhe burimi i fondeve të alokuara për thirrjen publike Grant2025 është 300 milion Lekë dhe detajet e më të hollësishme mund të gjendet në faqen zyrtare të internetit të Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, [www.sipermarrja.gov.al](http://www.sipermarrja.gov.al)

Financimi i grantit që mund të jepet për çdo projekt individual, është i përcaktuar nga fazat e zhvillimit të projekteve aplikuese dhe shumës totale të fondit për masa mbështetëse, të përcaktuar në buxhetin e Agencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve (“StartUp Albania”) për vitin 2025.

Financimi i grantit të dhënë mund të mbulojë:

- 100% të kostove totale të projektit në fazën 1 deri në vlerën 1,500,000 Lekë;
- 85% të kostove totale të buxhetit të projektit të miratuar në fazën 2, deri në vlerën 4,500,000 Lekë;
- 75% të kostove totale të buxhetit të projektit të miratuar në fazën 3, deri në vlerën 9,000,000 Lekë;

Bashkëfinancimi i pranueshëm përfshin burimet e veta të ligjshme të aplikantit nga të ardhurat operative ose fonde alternative, investimet private, kapitali sipërmarrës ose financimi i kapitalit privat, ose çdo burim tjetër privat sipas legjislacionit, për sa kohë që përjashton financimin nga ndonjë burim tjetër i sektorit publik.

Financimi i grantit të miratuar, bazohet në nevojat specifike të çdo projekti, fillimisht i dorëzuar nga aplikanti përmes buxhetit të projektit të propozuar. Megjithatë, përpara se të miratohet një aplikim për financim, komisioni i pavarur i vlerësimeve rezervon të drejtën për të modifikuar buxhetin e projektit të propozuar për të pasqyruar më mirë propozimin e aktiviteteve ose për të harmonizuar buxhetin e projektit të propozuar me rregullat dhe kërkesat e programit.

Afati përfundimtar i dorëzimit të aplikimeve është data 30.12.2024 në orën 23:00.

## 2. PRANUESHMËRIA E APLIKANTËVE

Në këtë thirrje ka tre grupe kriteresh të pranueshmërisë, që kanë të bëjnë me:

- (1) Aplikantët;
- (2) Llojet e projekteve që mund të financohen;
- (3) Kostot (llojet e kostove që do të merren parasysh).

Çdo aplikim nga *start up-et* do të shqyrtohet për përshtatshmërinë duke përdorur kriteret dhe kushtet e mëposhtme:

Aplikanti startup është në:

**Fazën Fillestare F1-** Individ privat, vendas ose të huaj, përfshirë nomadin digjital, të cilët kanë plan të vijojnë operacionet e biznesit në Shqipëri;

**Fazën e Validimit F2 ose në Fazën e Zgjerimit F3** – subjekt i regjistruar sipas ligjit në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë dhe jo më të vjetër se 6 (gjashtë) vjet në kohën e aplikimit.

Startup-et duhet të kenë përmbushur kushtin për shlyerjen e detyrimeve tatimore në momentin e kërkesës. Një aplikant **nuk** mund të marri pjesë më shumë se një herë për të njëjtën thirrje qoftë si individ, pjestar i një skuadre, administrator dhe/ose kombinim i tyre. Aplikantët që janë në fazën e zbatimit të grantit nuk mund të aplikojnë në thirrjen për Grant2025.

### Lehtësuesit duhet:

- a) Të jenë persona fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë ose në gjykatë në rastin e OJF-ve;
- b) Të jenë në pronësi të shtetasve shqiptarë minimalisht 60%;
- c) Të kenë kryer aktivitete në ndihmë të *startup-eve* gjatë 2 (dy) viteve të fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar nëpërmjet kontratave dhe raporteve /dokumenteve të publikuara;
- ç) Të kenë përmbushur kushtin për shlyerjen e detyrimeve tatimore në momentin e kërkesës;

Në rast se aplikimi do të jetë bashkëpunim mes një start up-i dhe një lehtësuesi, aplikanti do të ketë të drejtë të përdorë deri në maksimum prej 5% të vlerës së grantit për pjesëmarrje në aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga lehtësuesi. Start up-i vlerëson sipas nevojave dhe fushës së aktiviteteve, se cili nga lehtësuesit që plotëson kriteret e mësipërme është më i përshtatshëm për të realizuar projektin.

## Llojet e Projekteve të targetuara:

Kjo thirrje do të marrë në konsideratë financimin e projekteve që vijnë nga të gjitha fushat e ekonomisë, shkencës dhe teknologjisë duke i dhënë prioritet startup-eve në sektorë prioritarë dhe ato me zgjidhje në:

- Mbështetjen e iniciativave në sektorë prioritarë sipas Strategjisë S3,
- Projekte dhe ndërmarrje në ekonominë e gjelbërt<sup>1</sup> dhe dixhitale<sup>2</sup>;
- Mbështetjen e aplikantëve, me veprimtari në fushën e teknologjisë së informacionit dhe inovacionit, të cilët do të vendosin ta kryejnë aktivitetin e tyre në hapësirën fizike të Parkut Teknologjik Durana.
- Fuqizimin e të rinjve;
- Fuqizimin e vajzave dhe grave sipërmarrëse;
- Komercializimi i projekteve të bazuara në shkencë, kërkim dhe zhvillim;

## Sektori i Gjelbër

Sektori i gjelbër përfshin industri, aktivitete dhe inovacione që synojnë:

- **Reduktimin e ndikimit mjedisor** përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve.
- **Zvogëlimin e ndryshimeve klimatike** duke reduktuar emetimet e gazeve serrë dhe duke kaluar në burime të rinovueshme të energjisë.
- **Promovimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese** si riciklimi, ripërdorimi i materialeve dhe minimizimi i mbetjeve.
- **Rikthimin e ekosistemeve** dhe nxitjen e biodiversitetit.

Industritë kryesore në sektorin e gjelbër përfshijnë:

- Energjia e rinovueshme (p.sh., diellore, me erë dhe gjeotermale)
- Bujqësia dhe sistemet ushqimore të qëndrueshme
- Menaxhimi i mbetjeve dhe riciklimi
- Teknologjitë për efikasitet energjetik
- Ndërtimi i gjelbër dhe materialet e qëndrueshme të ndërtimit
- Menaxhimi dhe ruajtja e ujit

<sup>1</sup> Sektori i gjelbër përfshin industri, aktivitete të specifikuar në linkun në vijim <https://ëëë.startup-energy-transition.com/the-european-green-deal-industrial-strategy-the-role-of-start-ups/>

<sup>2</sup> Sektori i gjelbër përfshin industri, aktivitete të specifikuar në linkun në vijim <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A3202>

- Transporti i qëndrueshëm (p.sh., automjete elektrike dhe sistemet e transportit publik)

## Sektori Dixhital

Sektori dixhital i referohet industrive dhe aktiviteteve të përqendruara në teknologjinë dhe inovacionin dixhital. Ai fokusohet në:

- **Zhvillimin e infrastrukturës dixhitale**, përfshirë internetin me shpejtësi të lartë, rrjetet 5G dhe shërbimet cloud.
- **Industritë e bazuara në të dhëna** që shfrytëzojnë AI, të dhëna të mëdha (big data) dhe të mësuarit makinerik (machine learning).
- **Transformimin dixhital** të industrive tradicionale, duke rritur produktivitetin dhe konkurrencën.
- **Nxitjen e ekosistemeve inovative**, përfshirë startup-et dhe bizneset e teknologjisë.

Komponentët kryesorë të sektorit dixhital përfshijnë:

- Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK)
- Zhvillimin e softuerëve dhe shërbimet IT
- Inteligjencën Artificiale (AI) dhe të Mësuarit Makinerik
- Sigurinë Kibernetike
- Teknologjitë Blockchain dhe regjistrat e shpërndarë
- E-commerce dhe platformat dixhitale.

## 3. PËRDORIMI I FONDEVE TË GRANTIT

### 3.1 KOSTOT E PRANUESHME

Fituesit mund të përdorin fondet e granteve për kostot brenda kategorive të mëposhtme, duke mbajtur në konsideratë që 5% e fondit do të shkojë për lehtësuesit në rastet kur projekti paraqitet si bashkëpunim mes një start up-i dhe një lehtësuesi:

- Kostot e ekipit/pagave që angazhohen në projekt (shumat bruto përfshirë taksat mbi të ardhurat dhe përfitimet), **jo më shumë se 25% e vlerës totale të grantit;**
- Shërbimet e ekspertëve për zhvillim të produktit, duke përfshirë zhvillimin dhe testimin e teknologjisë, R&D, etj. **jo më shumë se 10% e vlerës totale të grantit;**
- Shërbimet e shitjes dhe marketingut, **jo më shumë se 10% të vlerës totale të miratuar të grantit;**
- Mallra dhe shërbime të tjera me qëllim rritjen dhe zhvillimin e kompanisë.
- Shpenzimet e përgjithshme të tilla si abonimet e teknologjisë/aplikimeve/të dhënave, ndërtim website etj;
- Aplikimi për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, industriale, patentë dhe certifikata përkatëse.



Duke marrë parasysh veçorinë e çdo aplikimi, përqindjet e buxhetit të projektit që janë të ndara për secilën kategori mund të ndryshojnë në varësi të qëllimeve të projektit. Të gjithë artikujt e listuar duhet të arsyetohet qartë nga aplikanti duke detajuar vlerën, kohën dhe buxhetin përkates. Zërat e buxhetit dhe shumatat mund të përshtaten nga komisioni i vlerësimit në mënyrë që të pasqyrojë më mirë qëllimet e projektit. Aplikantët duhet të marrin “Konfirmim me Shkrim” nga Sekretariati Teknik për monitorimin i Agjencisë Startup Albania, për çdo ekspert të jashtëm ose të brendshëm që planifikohen të angazhohen në projekt gjatë periudhës së zbatimit. Në rast se aplikanti nuk ka ndjekur procedurën e konfirmimit të ekspertit, shpenzimet për zërin përkates nuk do të njihen.

Në kuadër të Grantit 2025, fituesit marrin shërbime konsulence dhe ekspertize nga një institucion i arsimit të lartë publik. Sa më sipër, është në frymën e parashikimeve të VKM-së nr. 188, datë 13.3.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre” që njeh konceptin e përparësisë në ofrimin e shërbimeve për këto institucione duke parashikuar shprehimisht se *“kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësinë e tyre dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore të kërkojnë fillimisht, sipas nevojave, shërbime me fonde buxhetore, si: konsulenca, studime, ekspertiza apo trajnime/edukim në vazhdim nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit”* (pika1). Në këtë rast përshirja e institucioneve të arsimit të lartë publik i shërben dhënies së konsulencës dhe ekspertizës për industri të ndryshme (zhvillimi teknologjik, agrobiznesi, pronesia industriale dhe intelektuale etj.) gjatë fazës së zbatimit të projektit. Në rast se institucioni i arsimit të lartë nuk mund të realizojë shërbimet e kërkuara pasi nuk i ofron ato, atëherë fituesi vijon me angazhimin e ekspertëve në tregun privat, sipas vlerësimit të tij. Fituesi paraqet pranë Startup Albania dokumentacionin që provon mungesën e ofrimit të shërbimit nga institucionet e arsimit të lartë publik.

Vetëm kostot e grumbulluara gjatë periudhës kohore të specifikuar në kontratën e grantit dhe shërbimet e përfunduara, ose mallrat e dorëzuara, do të jenë të pranueshme për financim.

### 3.2 KOSTOT E PAPANUESHME:

Kostot e mëposhtme nuk do të konsiderohen të pranueshme, por nuk kufizohen në:

- Borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit (interesi);
- Provizionet për humbje, borxhe ose detyrime të mundshme në të ardhmen;
- Kostot e deklaruara nga përfituesi dhe të financuara nga një burim tjetër financues i Qeverisë Shqiptare gjatë të njëjtit viti kalendarik;
- Komisionet bankare;
- Shpenzimet doganore dhe taksa të tjera;
- Blerjet e tokës ose ndërtesave, qiratë dhe çdo rinovim;
- Humbjet nga këmbimi valutor, tarifat dhe gjokat;

- Kreditë për palët e treta;
- Kontributet në natyrë;
- Kostot e pagave të personelit të administratave shtetërore;
- Taksat, përfshirë TVSH-në, detyrimet dhe tarifat;
- Shpenzimet e argëtimit dhe mikpritjes;
- Per diems;
- Kostot e rekrutimit dhe zhvendosjes;
- Pagesat në para nga llogaria e projektit.

Agjencia Startup Albania do të verifikojë dokumentet e paraqitura në lidhje me kostot e papranueshme.

### 3.3 AKTIVITETE TË PAPANUESHME:

Kjo thirrje NUK do të mbështesë aplikime ose aktivitete në lidhje me:

- Pjesëmarrjen në panaire të armatimit dhe teknologjisë ushtarake;
- Pjesëmarrjen në panaire të teknologjisë së duhanit;
- Pjesëmarrjen në panaire si vizitor;
- Projekte argëtuese për të rriturit;
- Projektet e lojërave të fatit;
- Zhvillimin e pronës, përfshirë çdo rinovim;
- Çdo aktivitet tjetër që konsiderohet i paligjshëm sipas ligjit.

## 4. DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR STARTUP-ET DHE LEHTËSUESIT E STARTUP-EVE

Në mënyrë që aplikimi të vlerësohet, duhet që të dorëzohet i plotë, i strukturuar sipas paketës së dokumentacionit dhe brenda afatit të caktuar të dorëzimit në mënyrë elektronike përmes portalit *e-albania*. Lista e plotë e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim mund të gjendet në faqen zyrtare në internet të Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, [www.sipermarrja.gov.al](http://www.sipermarrja.gov.al).

Aplikantët shkarkojnë këto dokumente dhe njihen me përmbajtjen e tyre përpara se të fillojnë të përgatisin aplikimet e tyre. Periudha e aplikimit do të shoqërohet me sesione informuese fizike në disa qytete, sesione virtuale dhe/ose kërkesa me shkrim me anë të postës elektronike, të cilat kanë objektiv të sqarojnë aplikantët në mënyrë që ata të përgatisin një aplikim sa më të saktë.

Startup-et që aplikojnë për mbështetje financiare nga ky grant, duhet të dorëzojnë, gjatë aplikimit, dokumentacionin sipas listës së mëposhtme:

- i. Formularin e aplikimit të plotësuar;

- ii. Formatin e buxhetit të plotësuar;
- iii. Marrëveshjen e bashkëpunimit me lehtësuesin, kur aplikimi paraqitet si bashkëpunim;
- iv. Projektin teknik për realizimin e projektit, përfshirë kredencialet e lehtësuesit;
- v. Video prezantimin 2 minuta;
- vi. Historikun e aktivitetit për 2 vitet e fundit për lehtësuesit;
- vii. Ekstraktin dhe pasqyrat financiare për dy vitet e fundit të biznesit të certifikuar nga organet tatimore, nëse është e aplikueshme.

Pas paraqitjes së dokumentacionit përkatës, aplikantët i nënshtrohen dhe duhet të kalojnë procesin administrativ të kualifikimit, i cili do të zbatohet nga sekretariati teknik i ngritur pranë Agjencisë Startup Albania. Gjatë këtij procesi do të verifikohen:

- Pasaporta e Startupit (jo më e vjetër se dy vjet në momentin e aplikimit)
- Pasaporta e lehtësuesit (jo më e vjetër se dy vjet në momentin e aplikimit)
- Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT) për start up -in dhe për lehtësuesin, në rastin e personave fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar;
- Në rastin e organeve publike apo institucioneve publike të arsimit të lartë të cilët disponojnë pasaportën e lehtësuesit, duhet të paraqesin lejen me shkrim të titullarit për përfshirjen e stafit në projekt.
- Bilanci i vitit paraardhës për aplikuesin person fizik ose juridik të regjistruar mbi 1 vit në regjistrin tregtar;
- Bilanci i vitit paraardhës për lehtësuesin person fizik ose juridik të regjistruar mbi 1 vit në regjistrin tregtar
- Vërtetim për pagim detyrimesh tatimore, taksa lokale, OSHEE;
- Dëshmi penaliteti e aplikuesit (e lëshuar gjatë muajit të hapjes së thirrjes).

Modelet e aplikimit janë një pjesë integrale e Manualit të Thirrjes, Grante2025, dhe aplikantët duhet t'i përmbahen udhëzimeve të dhëna në këto dokumente standarte. Mosrespektimi i rregullave të mësipërme do të rezultojë në skualifikim të aplikimit. Personeli (stafi i projektit) ose individ është i kufizuar në një aplikim sipas thirrjes aktuale. Aplikimet ku i njëjti individ është pjesë e personelit të shumëfishtë, NUK do të kualifikohet për të marrë financim.

## 5. PROCEDURA E APLIKIMIT

- Formatet e aplikimit do të shkarkohen në linkun [www.sipermarrja.gov.al](http://www.sipermarrja.gov.al)
- Formatet e aplikimit do të plotësohen nga aplikuesi sipas standarteve dhe formateve të ofruara;
- Formulari i aplikimit dhe prezantimi i kërkuar duhet të jenë në formatin pdf;
- Formulari i buxhetit duhet të dorëzohet në format excel;
- Njësia menaxhuese e grantit pranë Agjencisë Shtetërore Startup Albania është e detyruar të marrë në dorëzim dhe shqyrtim çdo aplikim të paraqitur, i cili plotëson kriteret e kësaj rregulloreje;

- Nëse aplikuesi has paqartësi dhe vështirësi gjatë procesit të aplikimit, mund t'i drejtohen njësisë përgjegjëse pranë agjencisë Startup Albania, me shkrim në formë elektronike ose rrjeteve sociale.
- Aplikimi për mbështetje me Grant2025 do të kryhet online nëpërmjet faqes elektronike të portalit qeveritar *e-albania*;  
[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=16246](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=16246)
- Sekretariati teknik pranë agjencisë Startup Albania administron kërkesat së bashku me dokumentacionin shoqërues dhe i vendos në dispozicion anëtarëve të komisionit të vlerësimit dhe ankimit praktikant dokumentare dhe raportin përmbledhës të aplikimeve.

## 6. NGRITJA E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE ANKIMIT

Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas publikimit të “Thirrjes për kërkesa për masa mbështetëse”, me urdhër të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen ngrihet komisioni i vlerësimit dhe komisioni i ankimit, duke caktuar edhe kryetarët përkatës.

Komisioni i vlerësimit ka për qëllim shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave nga startup-et dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të cilët janë përfaqësues nga organet e administratës shtetërore, bota akademike, ekosistemi kombëtar dhe ndërkombëtar i start up-eve. Drejtori i agjencisë Startup Albania është anëtar i komisionit të vlerësimit për shkak të detyrës.

Komisioni i ankimit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të cilët janë përfaqësues nga organet e administratës shtetërore, bota akademike, ekosistemi kombëtar dhe ndërkombëtar i start up-eve.

### **Anëtarët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:**

Anëtari i komisionit i përzgjedhur nga organet e administratës shtetërore duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- i. Të jetë nëpunës i administratës shtetërore;
- ii. Të ketë pjesë të detyrave të tij funksionale hartimin, zbatimin ose monitorimin e politikave, programeve dhe projekteve për ekosistemin dhe kompanitë start up;

Anëtari i komisionit i përzgjedhur nga bota akademike duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- i. Të ketë të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune përkatëse në organizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë që kanë për qëllim mbështetjen ndaj kompanive start up dhe lehtësuesve të ekosistemit;
- ii. Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në menaxhimin e projekteve;

- iii. Të ketë përvojë në bashkëpunim ndërkombëtar në zhvillim të kompanive start up dhe të ekosistemit;
- iv. Të ketë përvojë si anëtar/kryetar i panelit të ekspertëve ose drejtor i propozimeve të programeve ose projekteve dhe anëtar/kryetar i komisionit të vlerësimit të fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Anëtarët përzgjidhen nga komisioni i vlerësimit pranë agjencisë Startup Albania dhe miratohet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për sipërmarrjen, mbi bazën e një procesi transparent, bazuar në thirrjen e hapur, të publikuar në faqen zyrtare të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

## **7. VLERËSIMI I KËRKESAVE PËR MASA MBËSHTETËSE**

Komisioni i vlerësimit mbledhet në mbledhjen e parë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendrike pas mbylljes së thirrjes për aplikime nga start up-et. Sekretariati teknik pranë agjencisë Startup Albania administron kërkesat së bashku me dokumentacionin shoqërues dhe i vendos në dispozicion anëtarëve praktikant dokumentare dhe raportin përmbledhës të aplikimeve. Në rastet kur është e nevojshme, komisioni ka të drejtë të kërkojë informacione ose dokumentacion shtesë nga aplikuesit. Informacioni ose dokumentacioni shtesë duhet të plotësohet nga aplikuesi brenda një periudhe kohore prej 3 ditësh nga momenti i njoftimit.

Mbledhjet e komisionit të vlerësimit thirren dhe drejtohen nga kryetari i këtij komisioni. Komisioni i vlerësimit merr në shqyrtim kërkesat për mbështetje me grant dhe në fund të procesit të vlerësimit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendrike miraton me vendim listën paraprake të aplikimeve fituese.

Komisioni i vlerësimit ushtron këto detyra dhe kompetenca:

- i. Shqyrton e vlerëson çdo aplikim;
- ii. Plotëson formularët e vlerësimit për çdo aplikim të dorëzuar dhe anëtarët e tij japin pikët individuale;
- iii. Përgatit renditjen paraprake të aplikimeve bazuar në pikëzimin dhe vendimmarrjen e të gjithë anëtarëve.
- iv. Harton dhe nënshkruan procesverbalin e vlerësimit dhe listën e aplikantëve të përzgjedhur për financim.
- v. Shqyrton ankesat e pranuar nga komisioni i ankimit dhe i rivlerëson ato sipas rastit.
- vi. Në përfundim të procesit të shqyrtimit, komisioni i vlerësimit harton listën përfundimtare dhe përcakton nivelin e grantit për përfituesit startup.

Kërkuesit mund të depozitojnë ankesat për shkelje të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për masa mbështetëse brenda 5 (pesë) ditëve kalendrike nga njoftimi elektronik. Komisioni i ankimit ka për qëllim shqyrtimin e ankesave për shkelje të procedurës së shqyrtimit nga

komisioni i vlerësimit. Në fund të vlerësimit të ankesave, komisioni i ankimit miraton me vendim kërkesat për t'ia kaluar për rishqyrtim komisionit të vlerësimit, ku parashtrohet edhe shkeljet procedurale. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga marrja e vendimit nga komisioni i ankimit, komisioni i vlerësimit merr në shqyrtim për herë të dytë aplikimet e atyre kërkuesve, ankesa e të cilëve është pranuar nga komisioni i ankimit. Pas shqyrtimit të dytë të aplikimeve, komisioni i vlerësimit merr vendimin për listën përfundimtare të fituesve, i cili i përcillet për miratim ministrit përgjegjës për sipërmarrjen. Urdhri i miratimit publikohet në faqen zyrtare të ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

Agjencia Startup Albania dhe subjekti përfitues nënshkruajnë kontratën e grantit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga miratimi i listës së përfituesve nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen. Në kontratën e grantit përcaktohen rregullat, afatet e përgjegjësitë e palëve për realizimin e projektit, dokumentacioni dhe afatet për raportimin përshkruar e financiar, mënyra e transferimit të fondeve, shpenzimet e njohura e të pranueshme, mekanizmat e raportimit e të kontrollit, përfshirë detyrimin e subjektit përfitues për të vënë në dispozicion të Kontrollit të Lartë të Shtetit dokumentacionin për veprimtarinë financiare të kryer, mënyra e dokumentimit të shpenzimeve të kryera dhe të produkteve e aktiviteteve të realizuara. Agjencia Startup Albania kryen lëvrimin e fondit sipas parashikimeve të kontratës së nënshkruar me fituesit e granteve.

Të gjitha komunikimet referuar proceseve të vlerësimit dhe ankimit do të kryhen nëpërmjet portalit e-albania dhe adresës elektronike [info@startupalbania.gov.al](mailto:info@startupalbania.gov.al).

## **8. PROCEDURA E DISBURSIMIT TË GRANTIT**

Disbursimi i grantit për projektet e shpallura fituese bëhet deri në 3 (tri) këste pas përfundimit të periudhës së mbylljes së çdo faze të projektit, kundrejt dorëzimit të faturës/ave të shpenzimeve të kryera dhe dokumentacionit të kërkuar, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në rregulloren “Për zbatimin dhe monitorimin e projekteve fituese të thirrjes për masa mbështetëse”.

Startup-eve iu lëvrohet fondi për projektin në 3 (tri) këste:

- i. Kësti i parë: 30% (tridhjetë përqind) të vlerës së fondit menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së grantit;
- ii. Kësti i dytë: 40% (dyzet përqind) të vlerës së fondit menjëherë pas miratimit nga Agjencia Startup Albania të raportit përshkruar dhe financiar të fazës së parë;
- iii. Kësti i tretë: 30% (tridhjetë përqind) të vlerës së fondit pas miratimit nga Agjencia Startup Albania të raportit përshkruar dhe financiar përfundimtar.

## 9. VLERËSIMI DHE VENDIMI PËR FINANCIM

Procedura e vlerësimit përfshin dy hapa:

- Kontrolli administrativ dhe i përshtatshmërisë së të gjitha aplikimeve të pranuar;
- Përzgjedhja e aplikimeve (bazuar në shqyrtimin nga komisioni I vlerësimit dhe ankimit);

Kriteret e mëposhtme do të përdoren nga anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe ankimit për të vlerësuar çdo projekt dhe pyetjet në kolonën e dytë do të shërbejnë si një udhëzues i përgjithshëm për vlerësuesit.

Kredencialet e ekipit dhe personelit kyç dhe aftësia e kompanisë për të lëvruar projektin	<ul style="list-style-type: none"> <li>• A ka ekipi menaxhues dhe personeli kryesor i duhur aftësitë, arsimi, njohuritë, historitë dhe përvojën për të ekzekutuar projektin e propozuar?</li> </ul>	Vlerësimi maksimal 10 pikë
Teknologji, produkt ose shërbim inovativ; dobia e inovacionit dhe pozicioni i qartë i pronësisë intelektuale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• A do të rezultojë projekti në përmirësimin e teknologjive, produkte apo shërbime ekzistuese?</li> <li>• Deri në çfarë mase projekti eksploron koncepte apo aplikime unike?</li> <li>• A ka teknologjia, produkti ose shërbimi i propozuar potencial për krijimin e PI-së të re?</li> <li>• A ka aplikanti pronësi/të drejta të plota për të zhvilluar dhe përdorur teknologjinë/produktin ose shërbimin që po zhvillohet?</li> <li>• A cenon teknologjia, produkti ose shërbimi i aplikantit ose shkelin të drejtat e PI të tjerëve?</li> </ul>	Vlerësimi maksimal 10 pikë
Nevoja e qartë e tregut dhe potenciali i komercializimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• A ka qasja e propozuar potencial për të çuar në treg një teknologji, produkt apo një proces të tregtueshëm?</li> </ul>	Vlerësimi maksimal 10 pikë



	<ul style="list-style-type: none"><li>• Cili është tregu specifik për teknologjinë, produktin apo procesin? A është një treg në rritje? A janë të përcaktueshëm klientët/përdoruesit?</li><li>• Vlerësoni avantazhin konkurrues të kësaj teknologjie kundrejt teknologjive alternative që mund të plotësojnë të njëjtat nevoja të tregut.</li><li>• A është teknologjia, produkti ose shërbimi konkurrues dhe çfarë janë kërcënimet konkurruese?</li></ul>	
Potenciali për të ardhura/partneritet me një partner strategjik brenda dy deri në tre (2-3) vjet pas fillimit të projektit	<ul style="list-style-type: none"><li>• A ka teknologjia, produkti ose shërbimi i propozuar potencial për të gjeneruar të ardhura brenda 2-3 viteve pas fillimit të projektit?</li><li>• A është real vlerësimi i tregut të synuar dhe kush janë/pritet të jenë konkurrentët kryesorë?</li></ul>	Vlerësimi maksimal 5 pikë
Përdorimi i fondeve dhe përshtatshmëria e buxhetit të projektit	<ul style="list-style-type: none"><li>• A është plani i propozuar një qasje e shëndoshë drejt komercializimit?</li><li>• A janë metodologjia dhe aktivitetet e përgjithshme të arsyetuara mirë dhe të përshtatshme për të realizuar zhvillimin e propozuar të teknologjisë, produktit apo shërbimit?</li><li>• A ka akses të mjaftueshëm në burime (materiale dhe furnizime, shërbimet analitike, pajisjet, objektet, etj) për të siguruar që projekti do të përfundojë me sukses?</li></ul>	Vlerësimi maksimal 10 pikë





Përdorimi i fondeve dhe përputhja me projektin	<ul style="list-style-type: none"><li>• A janë zërat e listuar në buxhet në përputhje me propozimin e aktiviteteve (p.sh. orët e punës, materialet)?</li><li>• A janë realiste kostot e propozuara?</li><li>• A do të përfitonte buxheti nga ndonjë ndryshim apo korrigjim (p.sh. më shumë fonde të alokuara për mbrojtjen e PIsë, duke reduktuar kostot e konsulencës)?</li><li>• A demonstroi aplikanti përkushtim të mjaftueshëm me nivelin e bashkëfinancimit?</li></ul>	Vleresimi maksimal 10 pikë
Teknologjia dhe rreziku i zbatimit dhe menaxhimit	<ul style="list-style-type: none"><li>• Janë problemet e mundshme të zbatimit, rreziqet dhe zgjidhjet e identifikuar të paraqitura qartë?</li><li>• A do të përcaktojë qasja e propozuar fizibilitetin dhe veçanërisht aspektet e rrezikut që mund të menaxhohen në mënyrë të përshtatshme?</li></ul>	Vleresimi maksimal 5 pikë
Bashkëpunimi në projekt me një lehtësues	<ul style="list-style-type: none"><li>• A ka përvojë lehtësuesi në zhvillimin e programeve mbështetëse për startup-et?</li><li>• A ka stafi i lehtësuesit kapacitete për të mbështetur startup-in në projekt?</li><li>• Çfare kontributi do të sjellë programi i lehtësuesit dhe si manifestohet gjatë programit.</li></ul>	Vleresimi maksimal 10 pikë

Bonus prej 5% mbi pikët e marra nga kriteret e mësipërme do të jepet në rastet kur:

- Aplikanti është vajzë/grua ose ekipi përbëhet nga të paktën 51% prej gra/vajza (në përputhje me parashikimet e nenit 14, pika 3/ç të Ligjit nr.25/2022, i ndryshuar;
- Aktiviteti thelbësor i startup-it ofron zgjidhje dixhitale dhe në ekonominë e gjelbër kjo kategori do të trajtohet me fond të dedikuar prej 30% të fondit total të grantit;
- Aplikanti startup ose individ aplikon së bashku me nje institucion lehtesues, sipas kritereve të përcaktuara në këtë dokument;

Rezultati total për një aplikim është shuma e pikëve të dhëna për secilin kriter, duke prodhuar një maksimum prej 70 pikësh.

## 10. PËRGJEGJËSITË E FITUESVE

Përgjegjësitë përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në:

- Respektojnë në mënyrë rigorozë dhe tërësore të gjitha deklaratat e shprehura dhe angazhimet e përfshira në formularin e aplikimit.
- Vënë në dispozicion të Agjencise Startup Albania çdo informacion, nëse i kërkohet.
- Paraqesin pranë komisionit të zbatimit dhe monitorimit një raport në lidhje me implementimin e projektit sipas fazave të specifikuara në kontratë deri në përfundimin e projektit, faturat origjinale për shpenzimet, si dhe çdo dokument të nevojshëm për të bërë të mundur kryerjen e pagesës;
- Pranojnë çdo lloj monitorimi, vlerësimi dhe/apo auditimi për të cilat projekti i aprovuar mund të bëhet objekt, duke siguruar të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, pasi të jenë njoftuar 7 (shtatë) ditë para.
- Përfundojnë projektin brenda kohës së parashikuar në marrëveshje.

Për më tepër, aplikanti angazhohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të parandaluar aktivitetet e mashtrimit dhe korrupsionit gjatë zbatimit të projektit. Në zbatim të kësaj politike, praktikatat që përbëjnë mashtrim dhe korrupsion përcaktohen si më poshtë:

(i) "praktikë korruptive" është ofrimi, dhënia, marrja ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo gjë me vlerë për të ndikuar në veprimet e një pale tjetër;

(ii) "praktikë mashtruese" është një veprim ose mosveprim, duke përfshirë keqinterpretim, që

mashtron me vetëdije ose pakujdesi, ose tenton të mashtrrojë, një palë për të siguruar financim

ose përfitim tjetër ose për të shmangur një detyrim;

(iii) "praktika të fshehta" është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve të krijuara për arritjen e një qëllimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e gabuar në veprimet e një palë tjetër;

(iv) "praktika shtrënguese" është dëmtimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të dëmtuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose indirekt, personat ose pasuria e tyre për të ndikuar në pjesëmarrjen e tyre në a procesin e prokurimit, ose ndikojnë në ekzekutimin e një kontrate;

(v) “praktikë penguese” është:

(a) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e materialit provues për hetimin ose dhënien e deklaratave të rreme para hetueseve me qëllim që materialisht të pengojnë një hetim mbi akuzat për një të korrumpuar, mashtrues, shtrëngues ose marrëveshje të fshehtë praktikë; dhe/ose kërcënimi, ngacmimi ose frikësimi i ndonjë pale për ta parandaluar atë zbulimin e njohurive të tij për çështjet që lidhen me hetimin ose nga ndjekja e tij

hetim, ose

(b) aktet që synojnë të pengojnë materialisht ushtrimin e të drejtave të inspektimit dhe auditimit.

## 11. MONITORIMI I GRANTEVE

Agjencia Startup Albania do të hartojë Udhëzuesin për zbatimin dhe raportimin e projektit, formatin e Raportit Përshkrues dhe Financiar dhe Manualin e Dukshmërisë. Gjithashtu, me urdhër të brendshëm do të përcaktohen personat përgjegjës për monitorimin, verifikimin dhe kontrollin e zbatimit të granteve. Përfituesit e granteve duhet të ofrojnë akses dhe raportojnë në çdo kohë për ekspertët monitorues të Agjencisë Startup Albania, pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit, për informacione dhe dokumente që lidhen me projektin dhe zbatimin e tij (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga Agjencia Startup Albania. Përfituesit e granteve do të kenë detyrimin për të hartuar raport përkshkrues/ financiar periodik për çdo këst dhe raportin përfundimtar. Raportet do të shoqërohen me faturat financiare që verifikojnë shpenzimet e kryera dhe me çdo dokument e produkt të përgatitur në kuadër të projektit dhe që verifikon aktivitetet e projektit.

**Përfituesit kanë detyrimin të mbajnë të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë dokumentet financiare) lidhur me projektin të paktën 5 (pesë) vjet pas përfundimit të tij. Gjithashtu, janë të detyruar të ofrojnë akses në këto dokumente ndaj çdo auditi dhe monitorimi nga ekspertë që përfaqësojnë Agjencinë Startup Albania si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, që ka kompetencë të kontrollojë shpenzimin e fondeve publike.**

## 12. KONFIDENCIALITETI I TË DHËNAVE

Në bazë të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. të dhënat personale dhe financiare të depozituara nga aplikuesit për qëllim të përfitimit nga granti, veçanërisht e gjithë korrespondenca e shkëmbyer është konfidenciale dhe nuk do të zbulohet.

Stafi i Agjencisë Startup Albania do të ruajë në mënyrë konfidenciale informacionet e marra nga startup-et. Asnjë e dhënë e marrë nga ana e aplikuesve nuk do t’u bëhet e ditur palëve të treta pa miratimin e tyre.



**Megjithatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, të dhënat në lidhje me zbatimin e grantit, në veçanti identifikimi i aplikuesve të mbështetur, të dhënat e përgjithshme rreth buxhetit, financimit, aktivitetet e kryera, rezultatet e arritura, ndikimet dhe të tjera të ngjashme, mund të përdoren, të publikohen ose shpërndahen nga stafi përgjegjës i Agjencisë pa ndonjë kufizim. Vetëm për raste të veçanta, të tilla si ngritja e ndërgjegjësimit, promovimi dhe shpërndarja, rastet studimore dhe të tilla të ngjashme, informacioni mund të zbulohet me marrëveshje të veçantë me startp-et e përfshira të cilat, nga ana e tyre, angazhohen për të lehtësuar zbulimin e informacionit, në rastet kur nuk cenohen interesat përkatëse tregtare dhe/ose sekretet e tyre.**

**Fundi i dokumentit.**